

"PRISHTINA ENERGJETIKE"



Projekti "P3-P5 Dalja 3"

"P3-P5 Dalja 3" është projekt në kuadër të megaprojektit investiv në rajonin e Prishtinës.

Plani investues i KEDS në Prishtinë përfshin rritjen e kapaciteteve të linjave ekzistuese nga 10 kV në 20 kV, krijimin e linjave alternative, futjen nën tokë të 90% të rrjetit të tensionit të mesëm, zëvendësimin e 50% të linjave të tensionit të ulët. Nga këto investime do të përfitojnë direkt 90 mijë konsumatorë.

Të dhëna specifike për projektin: Hapja e kanaleve të reja në shtrirje prej 2.2km. Do të përfshihen 20 transformatorë, vendosja e 11 km kablllove të reja të tensionit të mesëm.

Përfitues nga projekti "P3-P5 Dalja 3" : 3,955 konsumatorë

Lokacionet ku do të punohet: Rr. Maliq Pashë Gjinolli, Rr. Lidhja e Prizrenit dhe Rr. Kuvendi i Arbërit.

Periudha e zhvillimit të projektit: 2020 – 2021

Përfundimi i projektit: Korrik 2021

Gjatë zhvillimit të punimeve konsumatorët do të informohen paraprakisht 24-48 orë përmes uebfaqes, rrjeteve sociale dhe aplikacionit eKesco.

